



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
SHKOLLA 9-VJEÇARE "KASEM SHIMA" , KASHAR



Nr: 620 Prot

Tiranë, më 22/05/2015
(Lutemi referojuri në rast përgjigje)

LËNDA NJOFTIM PËR VËND TË LIRË PUNE

Drejtorja e shkollës 9-vjeçare "Kasem Shima" ,Tiranë, në zbatim të Ligjit Nr. 69 / 2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë ", të VKM Nr.66", datë 03.02.2010 ,, Për riorganizimin e Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore ,, si dhe të udhëzimit nr.58, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit nga puna të nëndrejtorit të institucionin arsimor publik të arsimit parauniversitar", shpall konkursin për vend të lirë pune në pozicionin **Nëndrejtor i Institucionit Arsimor Publik në :**
1.Shkollën 9-vjeçare *Kasem Shima* , Tiranë .

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

Kandidati/ja për nëndrejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet :

- Të ketë diplomë të nivelit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9741 , datë 21.05.2007 " Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë , të ndryshuar (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe e listës së notave të shkollës së lartë).
- Të ketë të paktën kategorinë "mësues i kualifikuar " dhe në provimin e kualifikimit të jetë vlerësuar " shumë mirë " ose "mirë"(fotokopje e noterizuar e dëshmisë së kualifikimit) .
- Të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij (nëse nuk ka , e deklaron me shkrim që nuk ka) .

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati/ja për nëndrejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet :

- a) CV-në dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë pohimet në CV (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi).
- b) Tabelën e plotësuar me të dhënat për aplikuesin (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr.2 , bashkëlidhur këtij udhëzimi).
- c) Dëshminë e penalitetit të lëshuar jo më herët se tri muaj para datës së aplikimit .
- ç) Deklaratën personale që vërteton se nëndrejtori nuk ka lidhje familjare me drejtorin e institucionit (bashkëshort/te , prind , vëlla/motër , fëmijë në moshë madhore etj.)
- d) Dy rekomandime nga mësues ose drejtorë të institucioneve arsimore ose titullarë të njësive arsimore vendore që kanë punuar me aplikantin gjatë viteve të fundit (Sipas modelit në shtojcën nr.3 , bashkëlidhur këtij udhëzimi).

Dokumentacioni i aplikimit , i përcaktuar në pikën 1, dorëzohet në drejtorinë e institucionit arsimor publik.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është 10 ditë pas shpalljes së kërkesës për nëndrejtor .

Konkurimi do të zhvillohet në ambjentet e shkollës së mesme të bashkuar Mezez, Tiranë në datën ,05/06/2015.

DREJTOR

Hasime LAMAJ

